



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 37, datë 05.02.2020

**PËR PLOTËSIMIN E 4 (NJË) POZICIONEVE PRANË ZYRËS SË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËRMES PROCEDURËS SË
KOMANDIMIT TË PROKURORËVE**

Mbështetur në nenin 53, nenin 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 176/3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përmes procedurës së komandimit të prokurorëve, konkretisht për pozicionin e Inspektorit.
2. Afati i komandimit do të jetë 5 (pesë) vjet.
3. Këshilli fton të gjithë prokurorët e Republikës së Shqipërisë të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - nuk shërbejnë në një pozicion me mandat të kufizuar,
 - kanë jo më pak se 13 vjet përvojë pune në funksionin e prokurorit,
 - nuk kanë masë disiplinore në fuqi,
 - janë vlerësuar “shumë mire” në dy vlerësimet e fundit,
 - nuk janë të komanduar në ndonjë pozicion tjetër, të shprehin interesin për t’u komanduar.
4. Shprehja e interesit duhet të bëhet jo më vonë se 2 (dy) javë nga Njoftimi për shprehjen e interesit në faqen zyrtare të Këshillit dhe të dorëzohet në adresën: **Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Qemal Stafa”, nr.1 Tiranë**. Mbi zarf duhet të shënohet: “Shprehje Interesi për Komandim pranë ILD”. Shprehja e interesit duhet të përmbajë: Letër motivimi ku kandidati shpreh arsyet dhe motivin e kandidimit për këtë pozicion pune (jo më shumë se dy faqe A4) si dhe një CV e përditësuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.



KRYETARI

GENT IBRAHIMI